

**STATUTI  
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË  
KUFIZUAR  
“SION” sh.p.k**



**HYRJE  
NENI 1**

1.1 Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar “SION” sh.p.k është themeluar nga ortakët : *me datë 26.09.2019.*

1.SOKOL ÇILI, atesia Petrika, lindur ne Tirane, me 22.07.1983, shtetas shqiptar, banues ne Tiranë, Kompleksi Kika 2, madhor me zotesi te plote juridike dhe per te vepruar, i pajisur me pasaporte nr personal I30722024B.

2.INDA ÇILI, atesia Ylli, lindur ne Tirane, me 15.06.1987, shtetase shqiptare, banues ne Tiranë, Kompleksi Kika 2, madhore me zotesi te plote juridike dhe per te vepruar, i pajisur me leternjoftimin nr personal I75615055J.

Themeluesit në përputhje me ligjin hartojnë edhe statutin e Shoqërisë si më poshtë:

**EMERTIMI I SHOQËRISË**

1.2 Emertimi I shoqërisë është “SION” sh.p.k.

**NENI 2**

Shoqëria krijohet në bazë të legjislacionit në fuqi të Republikës së Shqipërisë veçanerisht sipas ligjit 9901 dt. 14.04.2008 , Për Tregtarët dhe shoqëritë Tregtare” dhe si përsôn juridik , e zhvillon aktivitetin në përputhje me këtë legjislacion dhe me normat e këtij statuti. Ajo e fiton personalitetin juridik pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit .

**NENI 3  
FORMA**

3.1 Shoqëria “(DEAL)” sh.p.k. është “Shoqëri me Përgjegjësi të kufizuar” sh.p.k

**NENI 4**

4.1 Shoqëria e ka seline e saj ne Njesite Tregtare: Tirane, Rruga “Jordan Misja” Nr pasurie 8/176-N3, Volumi 34, faqe 155 dhe pasuria me Nr 8/176-N1, volumi 34, fq 153, Tirane Rruga “Jordan Misja”.



## NENI 5

### 5.1 Objekti I veprimtarisë së shoqërisë do të jetë:

Bar- Kafe, Snack (panine te ndryshme) si dhe pergatitje e ushqimeve te ndryshme, të kryejë çdo operacion tregtar, të ndërmarrë çdo veprim në lidhje me pasuri të luajshme dhe të paluajshme, si dhe çdo aktivitet tregtar, industrial, financiar, qiraje financiare, qiraje hipoteke, që mund të konsiderohet e dobishme apo e nevojshme për të arritur qëllimet e Shoqërisë, duke përfshirë çështje mbi garancitë personale dhe pasuri të paluajshme për detyrimet e të tretëve.

Të blejë drejtpërdrejtë apo tërthoraz, pjesmarrje në shoqëritë e tjera që kanë një qëllim të ngjashëm apo të lidhur me ato të shoqërisë, në Shqipëri apo jashtë shtetit, si dhe. Çdo aktivitet tjetër që mund të konsiderohet i dobishëm ose i nevojshëm për të arritur qëllimet e Shoqërisë.

Të blejë drejtpërdrejtë apo tërthoraz, pjesmarrje në shoqëritë e tjera që kanë një qëllim të ngjashëm apo të lidhur me ato të shoqërisë, në Shqipëri apo jashtë shtetit, si dhe.

Çdo aktivitet tjetër që mund të konsiderohet i dobishëm ose i nevojshëm për të arritur qëllimet e Shoqërisë.

## NENI 6

6.1 Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë pa afat dhe fillon nga momenti i regjistrimit të saj në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit me përjashtim të rasteve kur mbaron sipas parashikimeve në ligj ose kur vendos Asambleja e Përgjithshme .

## NENI 7

7.1 Shoqëria zhvillon aktivitetin e saj në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë dhe jashtë saj , gjithashtu ajo mund të hapë filial , degë ose përfaqësi në rrethe të ndryshme të Republikës së Shqipërisë apo në shtete të tjera në përputhje me legjislacionin e vendeve përkatëse.

## NENI 8

### KAPITALI I SHOQËRISË DHE Pjesët

8.1 Kapitali i shoqërisë ka vlerën 100 000 ( njëqindmijë) I cili ndahet në 2 kuota.

Vlera e kapitalit të shoqërisë është tërësisht I rimbursueshëm me kontributin e ortakëve sipas raportit të ortakëve.

8.2 Kapitali i shoqërisë mund të zmadhohet , me vendim të asamblesë së Përgjithshme. Në rast zmadhimi të kapitalit nëpërmjet shtimit të pjesëve të reja , ortakët kanë të drejtën e përparsisë në nënshkrim , proporcionalisht me shumën e pjesëve të tyre , e drejtë nga e cila ata mund të heqin dorë .

8.3 Kapitali i shoqërisë , mund të zvogëlohet me vendim të asamblesë së Përgjithshme . Zvogëlimi I kapitalit I prek të gjithë ortakët në të njëjtën masë ndaj pjesëve të kapitalit që ata përfaqësojnë.



## NENI 9

### KONTRIBUTET

Kapitali themeltar i shoqërisë do të jetë 100.000 (njëqindmije) leke. Ky kapital do të ndahet në kuota respektivisht si më poshtë. Kuotat e kapitalit themeltar të shoqërisë i perkasin :

1. SOKOL ÇILI , zoterues i 30 kuotave me vlerë të përgjithshme 50000 leke, që pëben 50 % të kapitalit themeltar të shoqërisë. *1 kuote*

2. INDA ÇILI , zoterues i 50 kuotave me vlerë të përgjithshme 50000 leke, që pëben 50 % të kapitalit themeltar të shoqërisë. *1 kuote*

Vlera e kapitalit themeltar të shoqërisë është shlyer plotësisht me kontributin e ortakëve sipas raportit të paraqitur më sipër .

Për nevoja të punës dhe ushtrimit të aktivitetit të saj shoqëria mund të celë llogari në cdo bankë të njohur me ligj , qoftë kjo private ose shtetërore.

## NENI 10

### TRANSFERIMI I KUOTAVE TË KAPITALIT

10.1 Kuotat e kapitalit të shoqërisë janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve dhe të transferueshme në rrugë trashigimie . Trashëgimtari , paraardhësi ose pasardhësi bëhen ortakë , nëpërmjet transferimit të kuotave të kapitalit.

10.2 Kuotat e kapitalit të shoqërisë mund tu transferohen personave të tretë që nuk bëjnë pjesë në shoqëri , me vendim të marrë me shumicën e ortakëve që përfaqësojnë të paktën  $\frac{3}{4}$  e pjesëve të kapitalit .

10.3 Në rast kur njëri apo disa nga ortakët dëshirojnë të transferojnë pjesërisht apo plotësisht kuotat që ata zotërojnë në kapitalin e shoqërisë tek të tretët , më parë duhet që oferta për shitje t'u bëhet ortakëve të tjerë të shoqërisë tek të tretët , më parë duhet që oferta për shitje t'u bëhet ortakëve të tjerë të shoqërisë , me të njëjtat kushte që do t'i bëhet të tretëve.

10.4 Trasferimi i kuotave do të bëhet me kontratë.

## NENI 11

11.1 Ortakët mbulojnë në personalisht humbjet e shoqërisë deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të nënshkruara . Kontributet e ortakëve përbëjnë kapitalin e regjistruar të shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar .

## NENI 12

### ORGANET DREJTUESE TË SHOQËRISË

#### ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME

12.1 Cdo ortak ka të drejtë të marrë pjesë në mbledhjet dhe vendimet e asamblesë së Përgjithshme , dhe disponon një numër votash të barabartë me kuotat e kapitalit që ai zotëron .

12.2 Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e Përgjithshme në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër , bashkëshorti ose një person tjetër I zgjedhur prej tij , me kusht që këta të jenë të autorizuar me prokurë ( përjashtohet përfaqësimi I një ortaku nga administrator I shoqërisë) .

12.3 Administratori i shoqërisë nuk mund të veprojnë si përfaqësues të ortakëve në asamblenë e përgjithshme .

12.4 Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të Asamblesë Përgjithshme , e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin redn dite.

12.5 Asambleja e Përgjithshme thirret nga administratorët , ekspertët kontabël të autorizuar po qe se ka të tillë , nga likuiduesit apo ortakët , të cilët përfaqësojnë të paktën 20 % të totalit të votimeve në asamblenë e përgjithshme të shoqërisë . këta ortakë mund t'i drejtojnë administratorëve një kërkesë me shkrim , përfshirë posten elektronikë për të thirrur asamblenë e përgjithshme dhe / ose përfshirjen e çështjeve të posacme në rendin e Ditës. Kërkesa duhet të përmbajë arsyet, objektivat dhe çështjet, për të cilat asambleja duhet të marrë një vendim . Nëse kërkesa refuzohet, këta ortakë kanë të drejtë ta thërrasin asamblenë dhe të caktojnë çështjet e rendit të ditës. Njoftimi do të bëhet me shkresë, ose nëpërmjet postës elektronike .

12.6. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përmbajë vendin, datën, orën ose çështja e kërkuar prej këtyre nuk futet në rendin e ditës, secili prej ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.

12.7. Nëse në kundërshtim me pikën 12.5 të këtij neni, asambleja e përgjithshme nuk thirret, ose çështja e kërkuar prej këtyre nuk futet në rendin e ditës, secili prej ortakëve që kanë bërë kërkesën, ka të drejtë të procedojë sipas ligjit në fuqi "Për Shoqëritë Tregtare".

12.8. Lajmërimi për mbledhjen e asamblesë së përgjithshme rregullisht bëhet nga administratorët.

Asambleja e Përgjithshme merr vendime për çështjet e mëposhtme dhe është përgjegjëse për to :

1. Përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë , ndryshimet e statutit.

2. Emërimin e shkarkimin e administratorëve.

3. Emërimin shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar .

4. Përcaktimin e shpërblimeve për administratorët, likuiduesit dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar .

5. Mbikqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë .

6. Miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe raporteve të ecurisë së veprimtarisë (pas marrjes dhe shqyrtimit të dokumentacionit përkatës ).

7. Zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit (pas marrjes dhe shqyrtimit të dokumentacionit përkatës ).

8. Pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre.

9. Përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë e në procedimet e tjera ndaj administratorëve .

10. Riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

11. Miratimin e rregullave proceduriale të mbledhjeve të asamblesë .

12. Çështje të tjera të parashikuara nga ligji.

Të gjitha vendimet e marra nga Asambleja e Përgjithshme regjistrohen në një regjistër të vendimeve, të dhënat e të cilit nuk mund të ndryshohen ose fshihen .

Duhet regjistruar në veçanti, por pa u kufizuar në to, vendimet për :

1. Miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecuresisë së veprimtarisë .

2. Shpërndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve , investime .

3. Vendimet për riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Vendimet e paregjistruara në regjistrin e vendimeve janë absolutisht të pavlefshme.

Sipas rëndësisë së vendimeve, mbledhja e asamblesë së përgjithshme mund të jetë e zakonshme.

Asambleja e përgjithshme e zakonshme vendos për çështje të tilla si emërimi ose shkarkimi i administratorëve, ekspertëve kontabël të autorizuar dhe likujduesve, miratimi i raporteve të administrimit dhe të kontrollit, miratimi i llogarive vjetore dhe Asambleja e zakonshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 30 % të kuotave dhe vendimet merren me  $\frac{3}{4}$  e pjesëmarrësve.

Asambleja e zakonshme vendos për çështje të tilla si ndryshimet e statutit, zvogëlimi dhe zmadhimi i kapitalit themeltar, transferimin tek të tretët, zgjatja e kohës së veprimtarisë së shoqërisë apo likuidimi i saj, shndërrimi i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar në shoqëri apo të formave të tjera, ndarja e fitimeve etj si dhe çdo çështje tjetër që parashikohet në ligj. Marrja e vendimeve të vlefshme bëhet vetëm nëse ortakët që zotërojnë më shumë se  $\frac{1}{2}$  e kuotave, janë të pranishëm, votojnë me shkresë apo mjete elektronike. Në këtë rast vendimet merren me  $\frac{3}{4}$  e ortakëve pjesëmarrës.

Me përjashtim të rasteve të parashikuara më sipër për çështjet e tjera të renditura në pikën 9 të këtij neni, Asambleja e Përgjithshme vendos shumicën e votive të ortakëve.

Nëse Asambleja e Përgjithshme nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur në këtë pikë, të këtij neni, asambleja mbledhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

## NENI 13

### ADMINISTRIMI

13.1. Shoqëria administrohet nga një ose më shumë administrator të cilët janë persona fizikë të zgjedhur brenda bashkësisë së ortakëve apo dhe jashtë saj.

13.2. Asambleja e Përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizikë si administrator të shoqërisë. Afati i emërimit është 5 vjet, me të drejtë ripërtëritjeje me përjashtim të rastit të dorëheqjes ose të shkarkimit të parakohshëm para mbarimit të afatit. Shkarkimi i administratorëve nga organi kompetent mund të bëhet në çdo kohë.

13.3. Emërimi i administratorëve prodhon efekte pas regjistrimi në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

13.4. Administratorët emërohen dhe shkarkohen me vendim të Asambleja e Përgjithshme sipas parashikimit në këtë statut.



**NENI 14**

**KOMPETENCAT E ADMINISTRATORËVE**

Administratorët kanë të drejtë e detyrohen të :

- a) kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare të vendosura nga Asambleja e Përgjithshme.
- b) përfaqësojnë shoqërinë tregtare.
- c) kujdesen për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë.
- ç) përgatisin dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecuresë së veprimtarisë dhe së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim.
- d) krijojnë një system paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë.
- dh) kryejnë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.
- e) raportojnë përpara Asambleja e Përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare.
- ë) kryejnë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.
- f) administratorët administrojnë shoqërinë bashkërisht ose secili veç e veç.
- h) asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme.

**NENI 15**

**EMËRIMI I PARË I ADMINISTRATORËVE**

15.1. Administrator i parë i shoqërisë për periudhën 5-vjeçare emërohet Zamira Dana atesia Adem, lindur ne Tirane, me 03.09.1954, banuese ne Tirane, madhore me zotesi juridike dhe per te vepruar, banuese ne Tirane, identifikuar nepermjet leternjoftimit Nr personal F45903074N

**NENI 16**

**EKSPERTË KONTABËL TË AUTORIZUAR**

16.1. Në rast nevojë si dhe kur kërkohet nga ligji, kontrolli kryhet nga një ekspert kontabël i autorizuar, i emëruar për dy vite financiare me mundësi rizgjedhjeje nga Asambleja e Zakonshme.

16.2. Shkarkimi i ekspertit kontabël i autorizuar vendoset në të njëjtat kushte si emërimi i tij, në rast se vërehen gabime, abuzime ose bëhet e pamundur kryerja e detyrës.



## **NENI 17**

### **VITI FINANCIAR**

17.1. Çdo vit financiar fillon nga 1 Janar dhe përfundon me 31 Dhjetor.

## **NENI 18**

### **LLOGARITË VJETORE**

18.1. Llogaritë vjetore, inventari , raportet mbi operacionet e vitit financiar dhe raportet mbi operacionet e vitit financiar dhe raportet e veçanta të hartuara nga administratorët dhe eventualisht nga eksperti kontabël i autorizuar , miratohen nga asambleja e zakonshme.

18.2.Miratimi i dokumentave veprimtarinë vjetore bëhet brenda një afati prej gjashtë muajsh nga data e mbylljes së vitit financiar

## **NENI 19**

### **DIVIDENTËT**

19.1. Pas miratimit të llogarive vjetore dhe evidentimit të ekzistencës së fitimeve, Asambleja e Ortakëve përcakton pjesën që u takon ortakëve në formën e dividendëve mbi fitimin proporcionalisht me përqindjen e pjesmarrjes së gjithsecilit në shoqëri. Fitimi që do të ndahet ndërmjet ortakëve në proporcione me pjesët e kapitalit ,përbëhet nga fitimi i vitit financiar të cilit i janë zbritur shumat e lëna mënjane për fondin rezervë të domosdoshëm (5 % të fitimit të çdo viti, deri sa ky fond të arrijë vlerën 1/10 e kapitalit themeltar) dhe nga ana tjetër I janë zbritur ose I janë shtuar respektivisht humbjet apo fitimet e mbartura nga vitet e mëparshme.

## **NENI 20**

### **PRISHJA**

20.1 Shoqëria priset me përfundimin e afatit të përcaktuar , kur kjo vendoset nga ortakët si dhe kur janë arsyet e parashikuara në ligj. Shoqëria nuk priset kur njëri prej ortakëve falimenton , bëhet I paaftë ose vdes , por vazhdon aktivitetin me ortakët e tjerë që kanë mbetur si dhe me trashëgimtarët e radhës së parë të ortakut që vdes.

## **NENI 21**

21.1 Shoqëria hyn në procesin e likujdimit të prishjes së saj . Për kryerjen e këtij procesi Asambleja emëron një likujdues , I cili I paraqet asaj raportin e likujdimit dhe mbi afatin e nevojshëm të përfundimit të tyre.

21.2 Në fund të procesit të likujdimit Asambleja vendos me vendimin e ortakëve që zotërojnë të paktën  $\frac{3}{4}$  e kuotave të kapitalit , mbi bilancin përfundimtar e financiar , mbi aktin e rregullshmërisë së punës së likujduesit dhe për mbylljen e procesit të likujdimit.

21.3 Pas pagimit të kreditorëve dhe shlyerjes së kuotave të kapitalit tek kontribuesit pjesët që ato zotërojnë në kapitalin themeltar.



#### **NENI 22**

#### **SHNDËRRIMI I SHOQËRISË**

22.1 Shndërrimi I shoqërisë me përgjegjsi të kufizuar në lloj tjetër shoqërie mund të kryhet vetëm me miratimin unanimit të ortakëve .

#### **NENI 23**

#### **MOSMARRVESHJET**

23.1 Të gjitha mosmarrveshjet që mund të lindin gjatë ekzistencës së shoqërisë ose gjatë periudhës së likuidimit midis ortakëve , ndërmjet Shoqërisë dhe ortakëve , do t'i paraqiten për zgjidhje Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë .

#### **NENI 24**

Për çështje që nuk janë parashikuar në këtë statut do të zbatohen dispozitat përkatëse të legjislacionit shqiptarë në fuqi “Për tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”

Ky statut nënshkruhet nga ne ortakët e shoqërisë “SION” Shpk me vullnet të lire dhe të plote.

### **ORTAKET E SHOQËRISË “ SION” SHPK**

**1.SOKOL ÇILI**

Sokol Çili

**2.INDA ÇILI**

Inda Çili



**AKT-THEMELIMI**

**I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR**

**“ SION ” (sh.p.k.)**

Sot, më 26.09.2019 (dymijë nentembëdhjetë), në mbështetje të legjislacionit shqiptar respektivisht ligjit Ligjit Nr. 9901, date 14.04.2008 “Per tregtaret dhe shoqerite tregtare” i ndryshuar, Ligjit Nr. 9723, date 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit, ne ortaket themelues:

**1.SOKOL ÇILI**, atesia Petrika, lindur ne Tirane, me 22.07.1983, shtetas shqiptar, banues ne Tiranë, Kompleksi Kika 2, madhor me zotesi te plote juridike dhe per te vepruar, i pajisur me pasaporte nr personal I30722024B.

**2.INDA ÇILI**, atesia Ylli, lindur ne Tirane, me 15.06.1987, shtetase shqiptare, banues ne Tiranë, Kompleksi Kika 2, madhore me zotesi te plote juridike dhe per te vepruar, i pajisur me leternjofitim nr personal I75615055J.

*te cilet me cilesine e "Ortakeve Themelues",mbeshtetur ne Kushtetuten e Republikes se Shqiperise dhe Kodin Civil ne fuqi,ne ligjin 9901 date 14.04.2008, "Per Tregtaret dhe Shoqerite tregtare", ne ligjin 9723, date 03.05.2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit", ne Kodin Doganor,Fiskal e Tatimor,krijojne shoqerine tregtare, me pergjegjesi te kufizuar,me emertimin " SION " shpk.*

**Neni 1**

Te themeloj nje Shoqeri me Pergjegjesi te Kufizuar per te ushtruar veprimtarine ekonomike, e emertuar “ **SION**” shpk.

**Neni 2**

Shoqeria do te jete e formes se Shoqerive Tregtare me Pergjegjesi Te Kufizuar dhe perballon humbjet sipas ligjeve ne fuqi.

**Neni 3**

Shoqeria e ka seline e saj ne Njesite Tregtare: Tirane, Rruga “Jordan Misja” Nr pasurie 8/176-N3, Volumi 34, faqe 155 dhe pasuria me Nr 8/176-N1, volumi 34, fq 153, Tirane Rruga “Jordan Misja”.

Ajo ka te drejte te krijojte brenda dhe jashte territorit te Republikes se Shqiperise, filjale, agjensi perfaqesimi, seli sekondare si dhe ti suprimoje ato.

**Neni 4**

Shoqeria do te kete nje kohezgjatje me kufi te pacaktuar dhe ajo mund te shperbehet ne çdo kohe me vendim te ortakeve.

Neni 5

Kapitali themeltar i shoqerise do te jete 100 000 (njqindmije) leke. Ky kapital eshte i ndare ne 100 kuota, secila prej tyre ka vleren 1 000 (njemije) leke.

Kuotat e kapitalit themeltar te shoqerise i perkasin :

1. **SOKOL ÇILI** , zoterues i (50) kuotave me vlere te pergjithshme 50000 leke, qe peben 50 % te kapitalit themeltar te shoqerise.

2. **INDA ÇILI** , zoterues i (50) kuotave me vlere te pergjithshme 50000 leke, qe peben 50 % te kapitalit themeltar te shoqerise.

Neni 6

Ne librin e llogarise se shoqerise do te krijohet "Fondi Themelor i Ortakeve".  
Rritja e kapitalit te ortakeve nuk eshte e kufizuar.

Neni 7

Te gjitha pjeset e kapitalit themelor jane teresisht te shlyeshme dhe te nenshkrueshme nga secili ortak i shoqerise.

Neni 8

**Objekti I veprimtarisë së shoqërisë do të jetë:**

Objekti I veprimtarisë së shoqërisë do të jetë:

Bar- Kafe, Snack (panine te ndryshme) si dhe pergatitje e ushqimeve te ndryshme, të kryejë çdo operacion tregtar, të ndërmarrë çdo veprim në lidhje me pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme, si dhe çdo aktivitet tregtar, industrial, financiar, qiraje financiare, qiraje hipoteke, që mund të konsiderohet e dobishme apo e nevojshme për të arritur qëllimet e Shoqërisë, duke përfshirë çështje mbi garancitë personale dhe pasuri të paluajtshme për detyrimet e të tretëve.

Të blejë drejtpërdrejtë apo tërthoraz, pjesmarrje në shoqëritë e tjera që kanë një qëllim të ngjashëm apo të lidhur me ato të shoqërisë, në Shqipëri apo jashtë shtetit, si dhe. Çdo aktivitet tjetër që mund të konsiderohet i dobishëm ose i nevojshëm për të arritur qëllimet e Shoqërisë.

Neni 9

Marredheniet e punesimit ne shoqeri do te rregullohen nepermjet Kontrates se Punesimit qe lidhet midis paleve ne mbeshtetje te Ligjit Nr. 7961 date 12.07.1995 (Kodi i Punes), si dhe akteve te tjera nenligjore te dala ne zbatim te tij.

Neni 10

Shoqeria gjate ushtrimit te aktivitetit te saj mund te zmadhoje ose te zvogeloje kapitalin themelor, ne baze te Ligjit Nr. 9901 date 14.04.2008, "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare".

Neni 11

Shoqeria vepron ne regjimin e prones private dhe merr persiper te drejta dhe detyrime vetem brenda kufirit te kapitalit te saj. Ortaket themelues mbartin rrezikun e veprimtarise se shoqerise vetem ne nivelin e kapitalit themeltar te investuar ne shoqeri.

Neni 12

Mosmarreveshjet qe mund te lindin gjate ushtrimit te veprimtarise tregtare te shoqerise, midis punonjesve te saj, si dhe me te tretet, kur ato nuk mund te zgjidhen me mirekuptim, ceshtja mbetet ne kompetence te Gjykates se Rrethi Gjyqesor Tirane.

Neni 13

Shoqeria do te kete vulen e saj ku jane percaktuar emri dhe inicialet e formes se saj ligjore

Neni 14

Pasuria e Shoqerise mund te sigurohet prane Shoqerive te Sigurimeve.

Neni 15

Shoqeria e pushon aktivitetin e saj me mbarimin e afatit te percaktuar ne kete kontrate ose per shkaqe te perligjura qe gjykohen te tilla nga ortaket.

Neni 16

Organet e shoqerise "SION" sh.p.k, jane:

- Asambleja e ortakeve.
- Administratori i shoqerise.

Modalitetet e formimit dhe funksionimit te tyre do te percaktohen ne Statutin e Shoqerise.

Administrator dhe perfaqesuesi ligjor i shoqerise eshte ZAMIRA DANA atesia Adem, lindur ne Tirane, me 03.09.1954, banuese ne Tirane, madhore me zotesi juridike dhe per te vepruar, banuese ne Tirane, identifikuar nepermjet leternjoftimit Nr personal F45903074N, per nje afat 5 vjeçar.

Modalitetet per ndryshimin e Administratorit si dhe kompetencat e tij rregullohen nga Statuti i Shoqerise dhe Ligji Nr. 9901 date 14.04.2008, "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare".

Ky akt themelimi nënshkruhet nga ne ortaket e shoqerise "SION" Shpk me vullnet te lire dhe te plote.

**THEMELUESIT E SHOQËRISË**

**1.SOKOL ÇILI**

Sokol Çili

**2.INDA ÇILI**

Inda Çili

REPUBLIKA E SHQIPERISE  
DHOMA E NOTEREVE TIRANE  
NOTERE GENTJANA A.DEDJA

NR. 4416 REP.

VERTETIM NËNSHKRIMI

Sot më datën 26.09.2019 (dymije e nentembedhete), dite e enjte, para meje noteres Gentjana A. Dedja, anëtare e dhomës noterëve Tiranë rrethi Gjygjësor Tiranë, me adrese Rruga "Skender Luarasi" Nr 19, u paraqiten :

**1.SOKOL ÇILI**, atesia Petrika, lindur ne Tirane, me 22.07.1983, shtetas shqiptar, banues ne Tiranë, Kompleksi Kika 2, madhor me zotesi te plote juridike dhe per te vepruar, identifikuar nepermjet pasaportes Nr. BR6269047, nr personal I30722024B.

**2.INDA ÇILI**, atesia Ylli, lindur ne Tirane, me 15.06.1987, shtetase shqiptare, banues ne Tiranë, Kompleksi Kika 2, madhore me zotesi te plote juridike dhe per te vepruar, identifikuar nepermjet leternjoftimit nr. 033641919, nr personal I75615055J.

Te lartpermendurit me dëshirën dhe me vullnetin e tyre te lirë dhe te plotë u paraqiten para meje noteres Gentjana Dedja, dhe nenshkruan ne prezencën time ne Dokumentin **Akt Themelimi + Statut te Shoqerise " SION" shpk** dt 26.09.2019 , redaktuar jashte kesaj zyre noteriale, dhe unë në bazë të ligjit "Per noterinë" Nr.110 dt 20.12.2018, vertetoj nenshkrimin e tyre dhe e nënshkruaj aktin pa vërejtje.



**NOTERE**  
**GENTJANA A. DEDJA**